

BROSHURA E UNIVERSITETIT TË TIRANËS PËR MATURANTËT



HISTORIKU I UT-SË

Universiteti i Tiranës është universiteti më i madh dhe më i vjetër publik në Republikën e Shqipërisë. UT u themelua në vitin 1957. Ai është zgjedhja e parë për të gjithë maturantët.

Në përbërjen e tij Universiteti i Tiranës ka 6 fakultete përkatësisht: Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave Sociale, Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Fakultetin e Ekonomisë dhe Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Në universitetin tonë studiojnë rreth 25 mijë studentë në të tre ciklet e studimit.

Universiteti i Tiranës është partner i Programit Erasmus + të Bashkimit Europian. Në kuadër të këtij programi, çdo vit, rreth 100 studentë nga Universiteti i Tiranës kryejnë një periudhë mobiliteti 6 mujore (një semestër) në një universitet europian. Të gjitha shpenzimet për këto shkëmbime mbulohen me fondet e Bashkimit Europian.

Universiteti i Tiranës gjithashtu është anëtar i shumë rrjeteve universitare të huaja si : UNICA, UNIMED, CMU, AUF, EUA etj. Universiteti i Tiranës ka një emër të madh, që çdo brez do të përpiqet jo vetëm ta ruajë, por ta çojë edhe më lart.

**KRITERET E PRANIMIT NË CIKLIN E
PARË TË STUDIMEVE BACHELOR PËR
VITIN AKADEMIK 2018-2019 SIPAS
FAKULTETEVE NË UNIVERSITETIN E
TIRANËS**

#Fakulteti i Drejtësisë

Nota mesatare e përgjithshme (mesatare e thjeshtë) e cila përbëhet nga nota mesatare e të gjithë viteve të shkollës së mesme (përfshirë edhe notat e provimeve të maturës shtetërore), të cilat përbëjnë 50 % të vlerësimit.

Nota mesatare e lëndëve të mëposhtme, të cilat përbëjnë 50 % të vlerësimit



Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	10 %
Histori	10 %
Qytetari	10 %
Ekonomi	10 %
Gjuhë e huaj (e parë)	10 %

#Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Mesatarja e thjeshtë aritmetike e përgjithshme 50% e vlerësimit, e cila përbëhet 25% nga mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë dhe 25% mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës shtetërore.

Nota mesatare e gruplëndëve 50 % e vlerësimit (kurrikula bërthamë). Në gruplëndët përfshihen lëndët me përqindjet përkatëse:

Programi i studimit - Biologji

Biologji	30 %
Kimi	10 %
Fizikë	5 %
Matematikë	5 %

Programi i studimit - Bioteknologji

Biologji	20 %
Kimi	10 %
Fizikë	10 %
Matematikë	10 %

Programet e studimit - Kimi; Kimi Industriale dhe Mjedisore; Kimi dhe Teknologji Ushqimorë

Kimi	20 %
Biologji	10 %
Fizikë	10 %
Matematikë	10 %

Programi i studimit - Fizikë

Fizikë	20 %
Matematikë	20 %
Kimi	5 %
Biologji	5 %

Programi i studimit Matematikë

Nota mesatare e tre viteve të lëndës Matematikë	50 %
---	------

Programi i studimit Informatikë; Teknologji Informaticioni dhe Komunikimi

Matematikë	25 %
TIK	10 %
Fizikë	10 %
Biologji	5 %

Programi i studimit Inxhinieri Matematike dhe Informatike

Matematikë	30 %
Nota mesatare e matematikës në maturën shtetërore	20 %

#Fakulteti i Shkencave Sociale



Nota mesatare aritmetike e tri viteve të shkollimit 50% e vlerësimit

Nota mesatare aritmetike e tri provimeve të maturës të detyrueshme (Gjuhë-Letërsi, Matematikë, Gjuhë e Huaj) 40% e vlerësimit.

Një provim me zgjedhje nga lista e provimeve me zgjedhje 10% e vlerësimit:

- a. Qytetari
- b. Sociologji
- c. Filozofi
- d. Psikologji
- e. Histori (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
- f. Gjeografi (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
- g. Biologji (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
- h. Ekonomi (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)
- i. Teknologji (nga kurrikula bërthamë ose e avancuar)

Shënim: Nëse maturanti jep dy provime me zgjedhje nga lista e kriterit 6.3 atëherë llogaritja bëhet duke marrë notën mesatare të tyre.

#Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë

Vlerësohet me 80 % të rezultatit përfundimtar
mesatarja aritmetike e tre viteve të studimit në
shkollën e mesme

Vlerësohet me 20 % të rezultatit përfundimtar
mesatarja aritmetike e lëndëve të Maturës Shtetërore



#Fakulteti i Ekonomisë

Nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë), të cilat përbëjnë 50 % të vlerësimit



Nota mesatare e gruplëndëve (për të gjithë vitet gjatë të cilave shtrihen lëndët, përfshirë notat e maturës shtetërore), të cilat përbëjnë 50 % të vlerësimit

Matematikë	15 %
Ekonomi	15 %
Fizikë	10 %
Gjuhë e huaj	10 %

#Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Mesatare e thjeshtë e cila rezulton nga mbledhja aritmetike e notave të tre viteve dhe notave të marra në provimet e maturës shtetërore pjestuar me numrin në total të notave të mbledhura



#Filiali Sarandë

Kriteret e pranimit për të dy programet e studimit të Filialit Sarandë do të jenë të njëjtat me kriteret që do të kenë Fakultetet bazë.

Fakulteti i Ekonomisë

programi Administrim
Biznesi

Fakulteti i Gjuhëve të
Huaja

programi Gjuhë
Angleze



**PROGRAMET
E STUDIMIT
NË CIKLIN
E PARË**

Fakulteti i Drejtësisë ofron programe në ciklin e parë të studimeve Bachelor në:

- Drejtësi

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron programe në ciklin e parë të studimeve Bachelor në:

- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- Bioteknologji
- Fizikë
- Biologji
- Kimi
- Kimi Industriale e Mjedisore
- Kimi dhe Teknologji Ushqimore
- Informatikë
- Matematikë
- Inxhinieri Matematike dhe Informatike

Fakulteti i Shkencave Sociale ofron programe në ciklin e parë të studimeve Bachelor në:

- Punë Sociale
- Psikologji
- Shkenca Politike
- Administrim dhe Politikë Sociale
- Filozofi
- Sociologji

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë ofron programe në ciklin e parë të studimeve Bachelor në:

- Histori
- Gjuhë Letërsi
- Gjeografi
- Gazetari me profile: Gazetari sociale kulturore, Gazetari politike, Gazetari ekonomike
- Arkeologji dhe trashëgimi kulturore

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ofron programe në ciklin e parë të studimeve Bachelor në:

- Gjuhë Angleze me profile; gjuhë angleze, përkthim dhe interpretim, studime britanike dhe amerikane
- Gjuhë Frënge me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim frëng, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Gjermane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Italiane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë, letërsi dhe qytetërim italiane, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Turke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Ruse me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim rus, përkthim dhe interpretim
- Gjuhë Spanjolle me profil: Gjuhë, letërsi dhe qytetërim hispanik
- Gjuhë Greke me profile; gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek, përkthim dhe interpretim

Fakulteti i Ekonomisë ofron programe në ciklin e parë të studimeve Bachelor në:

- Financë
- Ekonomiks
- Informatikë Ekonomike
- Administrim Biznesi

TI I TIRANËS



UNIVERSITETI I TIRANËS

Email: info@unitir.edu.al

Website: unitir.edu.al

Adresa: Rektorati, Sheshi "Nënë Tereza" Tiranë, Shqipëri

Kutia Postare Nr 183

Telefon: +355 4 2250165

